



# SHQIPËRIA

**Kryeqyteti:** Tirana  
**Popullsia:** 3,057,220  
**PBB për frymë (PPP):** 12,500\$  
**Indeksi i Zhvillimit Njerëzor:** I lartë (0.785)  
**Liria në Botë:** Pjesërisht e lirë (68/100)

## QËNDRUESHMËRIA E OSHC-VE: 3.7



Shqipëria është vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) që prej vitit 2014. Në vitin 2018, Këshilli i BE deklaroi se hapja e negociatave do të shtyhet deri në qershor 2019 pasi vendi nuk kishte bërë progres të mjaftueshëm në fusha të tilla si reforma gjyqësore, reforma në administratën publike, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Gjatë vitit 2018 situata politike në Shqipëri ishte e tensionuar. Partitë e opozitës bojkotuan parlamentin nga shtatori deri në dhjetor. Dy ministra të Ministrisë së Brendshme dhanë dorëheqjen njëri pas tjetrit (i pari në mars 2017 dhe tjetri në tetor 2018) pas akuzave - kryesisht nga opozita - se kishin lidhje me trafikun e organizuar të drogës. Tensionet u rritën, duke rezultuar në një përplasje midis zyrës së kryeministrit dhe zyrës së presidentit kur ky i fundit refuzoi të emërojë një ministër të ri të brendshëm dhe ktheu mbrapsht tre ligje të rëndësishme të miratuara nga parlamenti - ligji për prishjen e ndërtesës së Teatrit Kombëtar, ligji i buxhetit për vitin 2019, dhe një ligj për taksimin e bizneseve të mëdha.

Aktivizmi qytetar shënoi një nivel të ri në vitin 2018, ku grupe të shumta interesi zhvilluan protesta përgjatë vitit. U organizuan protesta kundër vendosjes së tarifave në një autostradë kryesore të quajtur Durrës-Kukës, ose Rruga e Kombit, protesta kundër prishjes dhe rindërtimit të Teatrit Kombëtar, dhe prishjes së banesave për t'i hapur rrugë ndërtimit të një unaze të re rreth Tiranës. Gjithashtu, një protestë e gjatë studentore parashtrroi si kërkesë një arsim të lartë cilësor dhe të përballueshëm në Shqipëri. Kjo e fundit e shkundi vendin dhe u portretizua nga media dhe në diskursin politik si një "shuplakë" ndaj qeverisë dhe që rezultoi në ndryshimin e Kabinetit të Ministrave.

Qëndrueshmëria e përgjithshme e sektorit të shoqërisë civile nuk pësoi ndryshime të mëdha gjatë vitit 2018, megjithëse përmirësime të vogla u vunë re në dimensionet e advokimit dhe të qëndrueshmërisë financiare. Advokimi u përmirësua si rezultat i mbështetjes aktive të OSHC-ve për zhvillimet socio-politike, ndërsa qëndrueshmëria financiare u përmirësua ndjeshëm për shkak se OSHC-të më të vogla dhe OSHC-të jashtë kryeqytetit rritën aksesin në fonde përmes programeve të nën-grantimit. Pavarësisht këtij përmirësi, qëndrueshmëria financiare mbetet dimensionimi më i dobët i qëndrueshmërisë së OSHC-ve dhe vijon të shoqërohet nga mungesa e diversifikimit të burimeve, varësia e lartë nga donatorët ndërkombëtarë, si dhe mungesa e theksuar e aksesit në fondet publike.

Sipas Gjykatës të Shkallës së Parë në Tiranë, në fund të vitit 2018 në Shqipëri rezultojnë të regjistruara 11,426 OSHC, përfshirë 400 OSHC (276 shoqata, 79 qendra, and 45 fondacione) të regjistruara rishtazi në vitin 2018. Megjithatë, numri i OSHC-ve të regjistruara pranë organeve tatimore, të cilat ofrojnë të dhëna të sakta të numrit të OSHC-ve aktive, është vetëm 4,503, pasi mbyllja ligjore e një OSHC-je përbën një proces të gjatë dhe të kushtueshëm.

## MJEDISI LIGJOR: 3.7



Kuadri ligjor i OSHC-ve në Shqipëri nuk pësoi ndryshime të mëdha gjatë vitit 2018. Ndërkohë që OSHC-të vazhdojnë të jenë përgjithësisht të lira nga ndërhyrja e qeverisjes qendrore, ato vazhdojnë të përballen me sfidat e regjistrimit, veprimtarisë dhe ngarkesave fiskale që rrjedhin nga një kuadër ligjor i paplotë ose i papërshtatshëm.

Procesi i regjistrimit të një OSHC-je në Shqipëri është i përqendruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. OSHC-të në zona të largëta ose ato që përfaqësojnë grupe të cenueshme e kanë theksuar prej kohësh procesin e centralizuar të regjistrimit dhe tarifën shoqëruese si pengesa për regjistrimin dhe funksionimin e tyre. Procesi i regjistrimit shpesh përfshin kosto të paparashikuara. Për shembull, gjykatat zakonisht përpilojnë me gabime dokumentacionin e regjistrimit të një OSHC-je dhe i duhet këtyre të fundit që t'i

rregullojnë ato. Mbyllja ligjore e një OSHC-je përbën një proces gjyqësor të gjatë dhe të kushtueshëm; prandaj, shumë organizata jofunksionale ekzistojnë vetëm në letër.

Sipas një reporti të muajit prill 2018 të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) është shënuar pak progres në zbatimin e Udhërrëfyesit të vitit 2015 për Politikën e Qeverisë Shqiptare, drejt një mjedisi më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile (ose quajtur ndryshe si Udhërrëfyesi), dokumenti strategjik që drejton politikën qeveritare në sektorin e shoqërisë civile. Raporti, i cili përfshin periudhën nga viti 2015 deri në prill 2018, tregon se nga pesëdhjetë e tre masat e planifikuara, vetëm katër janë zbatuar plotësisht, gjashtë janë në proces, dhe dyzet e një nuk janë zbatuar, ndërkohë që mungojnë të dhënat për dy nga masat. Për shembull, Udhërrëfyesi propozoi hapa për të decentralizuar procesin e regjistrimit, por raporti i KKSHC vë në dukje se nuk është arritur progres drejt këtij objekti.

Burimet e të ardhurave për OSHC-të, përfshirë tarifën e anëtarësimit, fondet, grantet, dhe donacionet, janë përjashtuar nga tarifa mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe tatimi mbi të ardhurat. OSHC-të që zbatojnë projektet e Instrumentit të BE-së për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA) kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim të TVSH-së për shpenzimet e tyre. OSHC-të mund të përfshihen në veprimtari ekonomike dhe ato që përfshihen në aktivitete ekonomike në fushat e arsimit, kulturës, sportit dhe mirëqenies sociale janë të përjashtuara nga TVSH-ja. Sidoqoftë, sipas kuadrit ligjor, të ardhurat nga veprimtaria ekonomike nuk duhet të përbëjnë më shumë se 20 përqind të buxhetit të përgjithshëm vjetor të një organizate, e cila kufizon ndikimin e veprimtarive ekonomike në qëndrueshmërinë e OSHC-ve. Sipas raportit të vitit 2018 "Trajtimi Fiskal i OJF-ve, Vlerësimi i Legjislacionit Kombëtar dhe Praktika për Organizatat Jofitimprurëse në Shqipëri" nga Partners Albania, një numër i OSHC-ve që janë regjistruar në autoritetet tatimore ndërmjet 2008 dhe 2014 përballen ende me politika të TVSH-së të ngjashme me sektorin privat dhe proceset e rimbursimit janë shumë sfiduese.

Kuadri ligjor ende nuk është nxitës i filantropisë. Donatorët e sektorit privat përfitojnë thjesht një zbritje prej vetëm 4 përqind të të ardhurave të tyre të tatueshme për donacionet, ndërsa individët nuk marrin asnjë zbritje tatimore për donacionet ndaj OSHC-ve. Nuk kishte asnjë nismë ligjore në vitin 2018 për të adresuar nevojën e përsëritur për një Ligj mbi Filantropinë që do të bëjë dallimin midis veprimtarisë filantropike dhe sponsorizimit.

Ligji për Vullnetarizmin dhe Ligji për Ndërmarrjen Sociale, që të dy hynë në fuqi në vitin 2016 dhe janë fusha me përparësi për Udhërrëfyesin, ende nuk janë plotësisht funksionale. Për shembull, aktet nënligjore që do të rregullojnë më tej marrëdhëniet midis vullnetarëve dhe OSHC-ve, përfshirë kërkesat për kontratat e vullnetarizmit dhe një kod etik për punë vullnetare, nuk janë miratuar ende. Për të lehtësuar zbatimin e Ligjit për Ndërmarrjen Sociale, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nxori një Udhëzim (Nr. 602) në janar që përcakton procedurat për dhënien e statusit të ndërmarrjes sociale. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave nxori dy vendime që detajuan më tej listën e miratuar të aktiviteteve dhe kategoritë e grupeve të pafavorizuara për ndërmarrjet sociale. Në fundit të vitit 2018, Këshilli i Ministrave nxori edhe Vendimin Nr.789, i cili parashikon krijimin e një fondi të

dedikuar për të mbështetur ndërmarrjet sociale në periudhën 2019-2021. Sidoqoftë, asnjë organizatë nuk i është dhënë statusi i një ndërmarrjeje sociale.

Legjislacioni rregullon qartazi veprimtarinë e OSHC-ve. Aktivitetet e vetme që OSHC-të nuk mund të ndërmarrin përfshijnë ato që shkelin të drejtat e njeriut, parimet kushtetuese ose ligjet e tjera. OSHC-të i nënshtrohen inspektimeve të kontrollit të veprimtarisë dhe pastrimit të parave si dhe inspektimeve të financimit të terrorizmit nga autoritetet tatimore. Kuadri ligjor parashikon kufij të qartë për mbikëqyrjen e qeverisë mbi OSHC-të dhe përgjatë vitit 2018 nuk është raportuar asnjë rast abuzimi ose ndërhyrje shtetërore. Gjatë vitit 2018, OSHC-të në Shqipëri vijuan të ushtrojnë të drejtën e tyre për të apeluar vendimet administrative dhe adresuan lirshëm debatet publike, shprehën kritika dhe morën pjesë në protestat publike.

Vazhdon të ketë një boshllëk në kapacitetin ligjor midis Tiranës dhe rretheve. Si rezultat, OSHC-të jashtë kryeqytetit hasin vështirësi në përfitimin e asistencës ligjore të specializuar pro bono. Si pjesë e projektit të tij të Klinikave të Ligjit, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë ka ngritur dy klinika ligjore në Durrës dhe Shkodër që ofrojnë ndihmë juridike dhe edukim juridik falas për qytetarët dhe komunitetin, përfshirë OSHC-të. Gjithashtu, gjatë vitit 2018, në disa raste, OSHC-të me qendër në Tiranë ofruan asistencë ligjore pro bono për OSHC-të e sapoformuara, përfshirë Euleus në Shijak dhe Komisionin e Qytetarëve në Selenicë në kuadër të projektit Instrumentet e Shoqërisë Civile kundër Korrupsionit (CIVILISC) të financuar nga BE.

## KAPACITETI ORGANIZATIV: 3.7

Kapaciteti organizativ i OSHC-ve në Shqipëri nuk ka ndryshuar gjatë vitit 2018. OSHC-të shqiptare vazhdojnë të hasin vështirësi në identifikimin dhe ndërtimin në mënyrë aktive të marrëdhënieve me bazën mbështetëse të mundshme dhe përfituesit e shërbimeve të tyre. Disa përfaqësues të OSHC-ve vërejnë se një OSHC mesatare në Shqipëri harxhon 70 përqind të kohës së saj në punë administrative dhe vetëm 30 përqind të kohës së saj në terren që lidhet me njerëzit, komunitetet dhe grupet, duke kufizuar mundësitë e saj për të ndërtuar një bazë mbështetëse të fortë. Kjo situatë ndikohet nga varësia e lartë e OSHC-ve shqiptare nga axhendat dhe përparësitë e donatorëve të huaj. Shumë OSHC kanë misione të përgjithshme në mënyrë që të jenë të pranueshme për më shumë mundësi financimi dhe vetëm një numër i kufizuar kanë plane strategjike të qarta dhe të përcaktuara.

Shumica e OSHC-ve kanë struktura dhe procedura formale, megjithëse ato nuk funksionojnë gjithmonë në mënyrë efektive. Në fondacionet dhe qendrat, bordet e drejtorëve janë nominalisht organet më të larta vendimmarrëse, por siç raportohet në vitin 2018 ata përfshihen rrallë herë në qeverisje. Asamblëtë e përgjithshme i shërbejnë këtij funksioni në shoqata. Edhe nëse ato ekzistojnë, politikat dhe procedurat e shkruara janë zakonisht shumë të përgjithshme dhe përgjithësisht punonjësit janë të panjohur me to. Shumica e OSHC-ve nuk publikojnë raporte vjetore. Në përgjithësi, OSHC-të nuk kanë politika të konfliktit të interesit.

Si rezultat i varësisë së tyre nga financimi i mbështetur në projekte, shumica e OSHC-ve në Shqipëri e kanë jashtëzakonisht të vështirë të mbajnë punonjës me kohë të plotë të cilët qëndrojnë në organizatë dhe kështu forcojnë aftësinë organizative me kalimin e kohës. Si rregull, çdo OSHC duhet të deklarojë të paktën një anëtar të stafit në zyrat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në çdo kohë, pavarësisht nëse ata po zbatojnë ndonjë projekt apo jo, çka paraqet një barrë të konsiderueshme financiare për OSHC-të, veçanërisht organizatat e vogla që funksionojnë mbi bazë vullnetare.

Angazhimi vullnetar në Shqipëri mbetet i ulët. Sipas Indeksit Botëror të Dhurimit 2018 të Charities Aid Foundation, vetëm 7 përqind e shqiptarëve raportuan se kanë marrë pjesë në nisma vullnetare gjatë vitit 2017, nga 10 përqind në 2016 dhe 11 përqind në 2015. Një mungesë e akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Vullnetarizmin të vitit 2016 pengon OSHC-të të mbështeten tek vullnetarët për të vazhduar punën kur nuk kanë fonde.



Zhvillimi i kapaciteteve organizative konsiderohet kryesisht një privilegj që mund ta ndërmarrin vetëm OSHC-të e mëdha. OSHC-të më të vogla rrallë herë janë në gjendje të përfshihen në përpjekje të tilla për shkak të mungesës së përgjithshme të fondeve, veçanërisht fondeve të dedikuara për zhvillimin institucional. Sidoqoftë, në vitin 2018, OSHC-të lokale kishin akses më të madh ndaj projekteve të financuara nga BE dhe skemave të nën-grantimit që përfshinin asistencë teknike për ndërtimin e kapaciteteve të tyre organizative. Disa kapacitete janë ende luks për shumicën e OSHC-ve për shkak të burimeve të tyre të kufizuara - këto përfshijnë marrëdhëniet me publikun dhe avancimin e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK), të dyja këto janë kritike për OSHC-të që të zhvillojnë, zgjerojnë ndikimin e tyre, si dhe të identifikojnë dhe arrijnë bazën mbështetëse dhe përfituesit e tyre.

## QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE: 4.4

Qëndrueshmëria financiare e OSHC-ve u përmirësua ndjeshëm gjatë vitit 2018 pasi OSHC-të e vogla dhe OSHC-të jashtë kryeqytetit kishin akses më të madh për fonde nëpërmjet programeve të nën-grantimit.



Në vitin 2018, donatorët ndërkombëtarë, përfshirë BE-në dhe Agjencinë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), vijuan të vendosin fonde në dispozicion të OSHC-ve më të vogla përmes projekteve me komponentë nën-grantimi të akorduara për OSHC-të më të mëdha kombëtare. Për shembull, gjatë vitit 2018, Qendra Kombëtare Shqiptare e Burimeve të Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC) ofroi nën-grante për OSHC-të përmes projektit të financuar nga BE-ja Partneriteti së bashku Kundër Korrupsionit (PACT) dhe Zhvillimi dhe Bashkëpunimi i Përsheptuar i Shoqërisë Civile i financuar nga USAID. Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, Co-PLAN, Partners Albania, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Qendra Rajonale e Mjedisit (REC-Shqipëri), dhe Terre des

Hommes Shqipëri gjithashtu ofruan nën-grante për OSHC-të lokale me fonde nga BE dhe SDC. Sidoqoftë, OSHC-të që përfitojnë nën-grante i nënshtrohen një pune administrative dhe dhe procedurave të vështira dhe grantet e vogla e bëjnë më të vështirë që të arrijnë ndikim të dukshëm.

Përkundër këtij zhvillimi pozitiv, qëndrueshmëria financiare vazhdon të jetë një dobësi e madhe për OSHC-të shqiptare. Shumica e OSHC-ve jo vetëm që nuk kanë qasje në burime të ndryshme të financimit, por gjithashtu nuk kanë vizion apo strategji për të diversifikuar burimet e tyre financiare. Shumica dërrmuese e OSHC-ve varen nga financuesit e huaj dhe kanë frikë se, ndërsa Shqipëria i afrohet anëtarësimit në BE, do të ketë ulje drastike të mbështetjes së huaj në dispozicion të tyre. Ndërkohë që burimet e brendshme të financimit po zhvillohen me ritëm të ngadaltë.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mbetet burimi kryesor i financimit publik për OSHC-të. Përmes thirrjeve të saj për propozime në vitin 2018, AMSHC ofroi dyzet e pesë grante që varionin nga 600,000 lekë (rreth 5.400 dollarë) deri në 4,000,000 lekë (rreth 36,000 dollarë). Fusha prioritare për këto thirrje për propozime ishte mbrojtja e mjedisit, por grante u dhanë gjithashtu për projekte të përqendruara në aktivizmin e të rinjve, fuqizimin e grupeve në nevojë, sundimin e ligjit, si dhe turizmin dhe promovimin e kulturës. Ministria e Kulturës financoi 128 projekte në vitin 2018 — njëzet e një më shumë se në vitin 2017 — me madhësi granti deri në 4500 dollarë për projekte të zbatuara nga individë dhe deri në 18,000 dollarë për projekte të OSHC-ve. Gjatë vitit 2018, Bordi i Çështjeve të Mirë të Lotarisë Kombëtare shpalli një thirrje për propozime me financim të përgjithshëm prej 230,000 EUR; nuk ka të dhëna për numrin e projekteve të mbështetura përmes këtij tenderi. Formalisht, fondet publike jepen në përgjithësi në mënyrë transparente, përfshijnë publikimin e thirrjeve publike me kritere të përzgjedhjes të përcaktuara qartë. Sidoqoftë, asnjë informacion nuk është publikuar mbi ankesat në lidhje me konkurrencën e këtyre proceseve.

Kuadri ligjor që rregullon aksesin e OSHC-ve në fondet e qeverisjes vendore mbetet i paplotë. Si rezultat, OSHC-të dhe organet e qeverisjes vendore nuk kanë qenë në gjendje të krijojnë mekanizma dhe praktika që do t'i

vendosnin fondet publike në dispozicion të OSHC-ve. Sipas raportit të KKSHC, disa akte nënligjore janë ende duke u hartuar, duke vonuar kështu progresin në prokurimin publik të shërbimeve sociale të ofruara nga OSHC-të.

Megjithëse ka një interesim në rritje si brenda sektorit, po ashtu edhe publikut të gjerë rreth bamirësisë dhe filantropisë, vetëm pak OSHC shqiptare kërkojnë mbështetje në mënyrë aktive nga komunitetet dhe baza e tyre mbështetëse. Vetëm OSHC-të e mëdha mund të përballojnë investimin për rritjen e kapaciteteve për thithjen e fondeve ose ta kontraktojnë atë si shërbim. Në vitin 2018, disa OSHC zbatuan aktivitete për të promovuar filantropinë. Për shembull, #GivingCircle është një iniciativë e Partners Albania për të mbështetur OSHC-të me ide ose iniciativa konkrete për të sjellë ndryshime sociale në komunitet. Në vitet e fundit, OSHC-të kanë përdorur gjithnjë e më shumë TIK në fushatat e tyre për mbledhjen e fondeve. Një sërë nismash të shoqërisë civile, duke përfshirë Fondacionin Fundjava Ndryshe dhe Down Syndrome Albania, grumbulluan fonde nëpërmjet përdorimit të medias sociale në vitin 2018. “Ti je një Luledielli” ndërtoi një aplikacion dhe një lojë të cilat përdoren së bashku me mjetet e mediave sociale për të mbledhur fonde për aktivitetet e organizatës për të ndihmuar fëmijët në nevojë. Sipas Indeksit Botëror të Dhurimit për vitin 2018, 28 përqind e të anketuarve shqiptarë raportuan se kanë dhuruar për bamirësi në vitin 2017, të njëjtën përqindje si në vitin 2016.

Bizneset kontribuojnë për OSHC-të nëpërmjet programeve të tyre të përgjegjësisë sociale të korporatave (PSK). Rrjeti Shqiptar i PSK, i drejtuar aktualisht nga Tirana Business Park, është përqëndruar në informimin dhe hulumtimin mbi PSK, identifikimin dhe promovimin e praktikave më të mira, dhe promovimin e partneriteteve ndër-sektoriale midis bizneseve, qeverisë dhe shoqërisë civile për të adresuar problemet sociale.

Ndërkohë vijojnë veprimtarinë disa ndërmarrje shoqërore, të tilla si biznesi me lule i Down Syndrome Albania dhe Biznesi Social Yunus, i cili ofron një sërë shërbimesh për zhvillimin e biznesit që synojnë të ndihmojnë sipërmarrësit të shndërrojnë idetë e tyre të biznesit në modele të qëndrueshme të biznesit. Në vitin 2018, Partners Albania hapi dyqanin e ëmbëlsirave Ke Buono në Fier, me mbështetje nga BE. Ky është rasti i parë në të cilin një pronë e konfiskuar e veprimtarisë mafioze është shndërruar në një ndërmarrje shoqërore.

Disa OSHC vazhdojnë të fitojnë të ardhura përmes ofrimit të shërbimeve, të tilla si trajnimi profesional dhe shërbimet bujqësore, megjithëse këto ofrohen zakonisht më lirë se çmimet e tregut. Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në vitin 2018, 679 organizata jofitimprurëse (shoqata, fundacione dhe qendra) angazhohen në veprimtari ekonomike. Sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), 319 organizata jofitimprurëse janë të licensuara dhe ofrojnë shërbime sociale dhe arsimore. Megjithatë, nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare që tregojnë shkallën e të ardhurave që ato gjenerojnë.

Pak OSHC mbështeten në anëtarësi dhe nga tarifat e anëtarësimit janë minimale. Sipas përfaqësuesve të OSHC-ve, gjatë vitit 2018, OSHC-të shqiptare pësuan një rritje të kostove të veprimtarive të tyre si rezultat i monitorimit dhe kontrollit të shtetit. Për shembull, OSHC-ve tani u kërkohet të deklarojnë dhe paguajnë taksat për tarifat e marrjes me qira për hapësirat e zyrave, pavarësisht nëse kostot e tyre aktuale të qirasë janë më të ulëta apo edhe falas. Gjithashtu, njësitë e qeverisjes vendore nuk bëjnë dallim të OSHC-ve nga bizneset kur mbledhin taksat siç janë taksat mjedisore, taksat e pastrimit dhe taksa e reklamës.

Një qasje e ngjashme raportohet të ndiqet nga sistemi bankar në Shqipëri. Sipas OSHC-ve, në vitin 2018 bankat vazhduan t'i trajtojnë ato njësoj si bizneset, duke e bërë jashtëzakonisht të vështirë për to aksesin e kredive. Për shembull, OSHC-ve u kërkohet të ofrojnë kolateral, të japin dëshmi të qëndrueshmërisë financiare dhe të paguajnë norma të interesit që mund të jenë të arsyeshme për bizneset, por janë jashtë mundësive të OSHC-ve. Për më tepër, procedurat dhe kërkesat e bankave për të përditësuar vazhdimisht dokumentet imponojnë barrë shtesë për OSHC-të.

Ekziston gjithashtu një shqetësim në rritje në sektorin e OSHC-ve në lidhje me konkurrencën nga organizatat ndërkombëtare, të tilla si Save the Children, Terre des Hommes dhe World Vision, të cilët po konkurrojnë gjithnjë e më shumë me OSHC-të lokale për fonde. Shumica e OSHC-ve shqiptare janë të kufizuara në aftësinë e tyre për t'u kualifikuar për këto fonde pasi u mungojnë sisteme adekuate të menaxhimit financiar. OSHC-të i nënshtrohen Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse, i cili përfshin auditime të pavarura të detyrueshme, por nuk dihet se deri në çfarë mase janë zbatuar këto detyrime.

## ADVOKIMI: 3.2

Advokimi i OSHC-ve u rrit ndjeshëm gjatë vitit 2018. Pavarësisht sfidave të vazhdueshme, OSHC-të diversifikuan dhe shtuan advokimin e tyre gjatë vitit.

Zbatimi i Ligjit 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, i cili rregullon procesin e njoftimit dhe konsultimit publik të projektligjeve, draft dokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, dhe politikat me interes të lartë për publikun, vazhdojnë të jenë të dobëta. Proceset e konsultimit si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal të qeverisjes në përgjithësi trajtohen si formalitete përmes të cilave zyrtarët publikë informojnë OSHC-të në lidhje me iniciativat e politikës dhe vendimmarrjes në vend që të kërkojnë kontribut nga publiku dhe grupet e interesit përfshirë OSHC-të. Për shembull, procesi i konsultimit të Ligjit për Rininë e paraqiti ligjin e propozuar si versionin përfundimtar. Ndodh shpesh që njoftimet për ngjarje të tilla ose reklamohen dobët, ose jepen me njoftim të shkurtër, ose të dyja. Për më tepër, është e vështirë të gjurmosh rezultatet e konsultimeve në mënyrë që të përcaktohet se çfarë ndikimi mund të ketë pasur secili aktor në këtë proces. Për shembull, është e vështirë të gesh ndonjë koment nga publiku në platformën online për konsultime publike [konsultimipublik.gov.al](http://konsultimipublik.gov.al).

Sipas një studimi të kryer nga IDM në vitin 2018 të quajtur Monitorimi Kombëtar i Reformës së Administratës Publike (RAP) 2017/2018, vetëm 45 përqind e OSHC-ve të anketuara ishin dakord që procedurat zyrtare të konsultimit plotësonin parakushtet për përfshirje efektive në hartimin e politikave, dhe vetëm 19 përqind ishin dakord që institucionet publike përdorin në mënyrë të vazhdueshme procedurat e konsultimit kur hartojnë politika brenda fushës së tyre. Vetëm 12 përqind e OSHC-ve të anketuara deklaruan se ministrinë përkatëse u japin përgjigje me shkrim nëse kontributi i tyre gjatë konsultimit ishte reflektuar dhe vetëm 10 përqind thanë që ministrinë përkatëse pranuan mendimet e organizatës së tyre.

Gjithashtu, sipas Monitorimit Kombëtar RAP 2017/2018, perceptimi i shoqërisë civile rreth qasjes në informacione publike nuk është shumë pozitiv. Bazuar në përvojat e tyre me kërkesat për informacion, 39 përqind e OSHC-ve raportuan probleme me informacionin që nuk është në formatin e kërkuar dhe 31 përqind theksuan që informacioni nuk jepet brenda afateve të përcaktuara.

KKSHC vijoi të promovojë bashkëpunimin e qeverisë me OSHC-të në vitin 2018 dhe u mbledh disa herë gjatë vitit 2018. Siç parashikohet me ligj, Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian (KKIE) promovon bashkëpunimin midis partive politike, strukturave shtetërore dhe OSHC-ve në proceset e integritit në BE. Sipas faqes zyrtare të Parlamentit Shqiptar, KKIE u mbledh tre herë gjatë vitit 2018 dhe vijoi të mbështesë Shkollën Verore Evropiane, e cila promovon përfshirjen aktive të të gjithë palëve të interesuara në zbatimin e reformave të BE-së. Në vitin 2018, Këshilli i Ministrave nxori një vendim për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Pesë prej anëtarëve të këshillit janë përfaqësues të OSHC-ve aktive në zonë dhe këshilli pritet të mblidhet të paktën dy herë në vit.

Advokimi në nivelin kombëtar vazhdoi në vitin 2018 me të njëjtin ritëm si në vitin 2017. Advokimi i OSHC-ve çoi në miratimin e Ligjit Nr.22 / 2018 për Strehimin Social. Parlamenti përfshiu kontributin e OSHC-ve në ligj, i cili tani pasqyron standarde të reja ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen dhe mbështetjen e grupeve të cënueshme shoqërore, veçanërisht viktimat e dhunës. OSHC-të mjedisore ishin në qendër të Aleancës kundër Importit të Mbetjeve (AKIP), e cila kundërshtoi inceneratorin e Fierit në janar dhe maj. OSHC-të mjedisore dhe aktivistët lokalë protestuan gjithashtu kundër hidrocentraleve në Kukës dhe Valbonë në mars dhe shtator. OSHC-të dhe koalicionet e ngritura për çështje specifike protestuan në prill kundër vendosjes së tarifave në Rrugën Durrës-Kukës dhe në shtator kundër ligjit për Teatrin Kombëtar. Studentët protestuan në muajin dhjetor për të kërkuar cilësi të përmirësuar në arsimin e lartë dhe një rritje të buxhetit kombëtar për arsimin.

OSHC-të ishin gjithnjë e më shumë të angazhuara në iniciativat e advokimit që synojnë proceset e vendimmarrjes dhe të hartimit të politikave në nivelin lokal, gjithashtu, pjesërisht sepse praktikat e nën-grantimit kanë krijuar më shumë mundësi për advokimin lokal. Për shembull, në Tiranë, një numër i OSHC-ve formuan një koalicion informal




për të kundërshtuar, nga perspektiva e të drejtave të njeriut, propozimin e bashkisë që ndër të tjera penalizon lypjen dhe grafitin. Rregullat e reja u miratuan pavarësisht kundërshtimeve të ngritura. Nisma të tilla nuk janë më të kufizuara në kryeqytet dhe bashkitë e mëdha. Në fakt, bashkitë më të vogla - të cilat zakonisht kanë më pak burime njerëzore dhe kapacitete më të ulëta - shpesh janë më të hapura për përfshirjen e OSHC-ve në politikat pjesëmarrëse dhe vendimmarrje. Për shembull, OSHC-të në Elbasan dhe Korçë raportuan se gjatë vitit ato ishin të angazhuara rregullisht në proceset lokale të konsultimit, siç janë proceset e buxhetimit me pjesëmarrje dhe hartimi i planeve vendore, përfshirë planet sociale dhe planet për integrimin e romëve, personave me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve, dhe që disa nga sugjerimet dhe propozimet e tyre u morën në konsideratë në politikat përfundimtare.

OSHC-të vazhdojnë të përfshihen informalisht në aktivitete lobuese. Sidoqoftë, mungesa e një kuadri ligjor për të rregulluar aktivitetet e lobimit e bën të vështirë ndjekjen dhe raportimin e këtyre përpjekjeve.

BE-ja vazhdoi të ofrojë mbështetje teknike në krijimin e një mjedisi më mundësues për OSHC-të, nëpërmjet një projekti nëntë mujor (nëntor 2017 deri në korrik 2018) i zbatuar nga DAI Europe. Sidoqoftë, OSHC-të nuk janë angazhuar në advokim të mirëfilltë lidhur me me legjislacionin që rregullon sektorin dhe është bërë pak progres në avancimin e ligjeve dhe rregulloreve të lidhura me OSHC-të në vitin 2018. Ligjet kryesore me interes të drejtpërdrejtë për OSHC-të, siç është Ligji për Vullnetarizmin (miratuar në 2016), Ligji për Ndërmarrjen Sociale (miratuar në vitin 2016) dhe Ligji për Njoftimin dhe Konsultimet Publike (miratuar në vitin 2014) të gjitha mbeten vetëm pjesërisht të zbatuara për shkak të kuadrit ligjor të paplotë. Në vitin 2018 nuk u iniciua ndonjë proces për të zhvilluar një ligj të ri për filantropinë.

## OFRIMI I SHËRBIMEVE: 3.6



Ofrimi i shërbimeve të OSHC-ve nuk pësoi ndryshime të mëdha gjatë vitit 2018. OSHC-të vazhdojnë të ofrojnë shërbime të larmishme duke filluar nga mirëqenia sociale, arsimit dhe shërbimet shëndetësore e deri te shërbimet që synojnë forcimin e kapaciteteve të sektorit dhe promovimin e hartimit të politikave të bazuara në fakte. Për më tepër, në vitin 2018 OSHC-të përfshirë Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare, Komitetin e Helsinkit në Tiranë dhe Fondacionin e Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, ofruan ndihmë ligjore falas për qytetarët.

Numri i OSHC-ve që merren me ofrimin e shërbimeve është rritur dhe diversifikuar në mënyrë graduale. Sidoqoftë, nuk janë përmbushur pritshmëritë për përmirësime të mëtejshme gjatë vitit 2018. Ndërkohë që strukturat shtetërore në nivelin qendror dhe vendor vlerësojnë gjithnjë e më shumë rolin që shoqëria civile

mund të luajë në ofrimin e shërbimeve, veçanërisht ato që synojnë grupet dhe individët e cenueshëm, nuk është arritur aspak progres në materializimin e mbështetjes së qëndrueshme financiare në vitin 2018. Reforma administrative-territoriale që u iniciua në vitin 2014 dhe procesi i decentralizimit që pasoi, caktuan përgjegjësi të reja për njësitë e qeverisjes vendore, përfshirë zhvillimin e planeve vendore sociale. Disa bashki hartuan planet vendore sociale gjatë vitit 2018. OSHC-të vendore morën pjesë në mënyrë aktive në këtë proces dhe u konsideruan si partnerë të rëndësishëm në realizimin e planeve, veçanërisht për ofrimin e shërbimeve sociale. Megjithatë, kuadri i paplotë ligjor vazhdon të kufizojë qasjen e OSHC-ve në fondet e qeverisjes vendore, megjithëse janë bërë disa hapa për të korrigjuar këtë situatë. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.111, datë 23 shkurt 2018, për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social parashikon që njësitë e qeverisjes vendore të drejtohen tek OSHC-të për shërbimet sociale që nuk mund t'i ofrojnë vetë, megjithëse ata ende nuk kanë rregullore ose praktika të prokurimit për shërbimet e OSHC-ve.

OSHC-të përpiqen vazhdimisht të zhvillojnë dhe përmirësojnë shërbime për grupe specifike të synuara siç janë viktimat e dhunës, viktimat e trafikimit, fëmijët në nevojë, të moshuarit dhe njerëzit me aftësi të kufizuara. Shumë

OSHC përpiqen të vlerësojnë nevojat e komuniteteve dhe bazës së tyre mbështetëse dhe më pas t'i përshtasin shërbimet sipas nevojave të tyre. Sidoqoftë, këto vlerësime bëhen përgjithësisht në një formë informale dhe jo sistematike. Në përgjithësi OSHC-të nuk janë në gjendje të ofrojnë shërbime të mjaftueshme për të gjithë ata që kanë nevojë për to.

OSHC-të vazhdojnë të përpiqen të rikuperojnë kostot e ofrimit të shërbimeve. Shumë përfitues nuk janë në gjendje të paguajnë për shërbime, dhe OSHC-të kanë akses të pamjaftueshëm në burime të tjera të ndihmës financiare për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimeve. Interesi i donatorëve të huaj për të mbështetur ofrimin e shërbimeve është në rënie, ndërsa interesi për studime, botime dhe trajnime po rritet. Burimet e financimit të brendshëm janë të pazhvilluara dhe OSHC-të ende kanë qasje të kufizuar në fondet e qeverisjes vendore. Këto kushte e bëjnë pothuajse të pamundur që OSHC-të të specializohen në ofrimin e shërbimeve.

## INFRASTRUKTURA E SEKTORIT: 3.7

Infrastruktura që mbështet sektorin e OSHC-ve nuk pësoi ndryshime të mëdha gjatë vitit 2018. Ndikimi pozitiv i rritjes së praktikave të nën-grantimit dhe mbështetja teknike ndaj OSHC-ve më të vogla u ekuilibrua nga rritja e kostove të veprimtarisë të cilat kanë kufizuar mundësitë e OSHC-ve për të investuar dhe zhvilluar infrastrukturën dhe kapacitetet e tyre.

Në Shqipëri nuk ka organizata mbështetëse (ISO) që i ofrojnë OSHC-ve shërbime si trajnime. Po ashtu, ka pak qendra burimore të OSHC-ve dhe ato që ekzistojnë nuk janë lehtësisht të aksesueshme për OSHC-të lokale. Si pjesë e strategjisë së saj, Partners Albania ofron trajnime për zhvillimin institucional të OSHC-ve. Partners Albania ka përgatitur një kurrikul të përshtatur për nevojat specifike të secilit prej sektorëve me të cilët punon. Disa OSHC, përfshirë Lëvizjen Evropiane Shqipëri (EMA), IDM, Co-PLAN, dhe Institutin Shqiptar për Studime Ndërkombëtare (AII), angazhohen në hulumtimin e politikave, analiza, konsulencë dhe advokim; ofrojnë shërbime dhe trainime për ndërtimin e kapaciteteve; organizojnë debate publike dhe forume politikash; dhe zhvillojnë indikatorë monitorimi për çështje të caktuara me rëndësi të madhe publike. Me financimin e BE-së, programi PACT ofron trajnime të trajnerëve dhe seminare rajonale trajnimi mbi qeverisjen e mirë dhe anti-korrupsionin; seminare trajnimi në gazetarinë hetuese; angazhimin qytetar të të rinjve dhe zhvillimin e projekteve; asistencën teknike dhe mentorimin e zhvillimit organizativ; dhe menaxhimin e ciklit të projektit.

OSHC-të menaxhuan një numër të madh të projekteve me nën-grantim gjatë vitit 2018. Në kuadër të projektit PACT të financuar nga BE, ANTTARC i ofroi OSHC-ve 29 nën-grante me vlerë përafërsisht 350,000 EUR. ANTTARC gjithashtu nënshkroi 19 marrëveshje me OSHC-të në një total prej 475,000\$ si pjesë e projektit të USAID për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin e Përsheptuar të Shoqërisë Civile. Projekti LevizAlbania i financuar nga SDC, i cili zbatohet nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Co-PLAN, dhe Partners Albania, ofruan mbështetje për 81 projekte të zbatuara nga OSHC-të dhe individët me një buxhet total prej 1,681,500 CHF (afërsisht 1.7 milion \$). IDM zbaton projektin CIVILISC të financuar nga BE, duke dhënë në total rreth 150,000 EUR për gjashtë rrjete organizatash (që përbënin 18 organizata në total) në vitin 2018. Gjithashtu, IDM dha dy grante të tjera me një shumë totale prej 35,000 EUR për OSHC-të vendore si pjesë e projektit rajonal të financuar nga BE Programi i Grantit të Ndërtimit të Kapaciteteve dhe Advokimit për Zhvillim të Qëndrueshëm Rural në Ballkanin Perëndimor. Nëpërmjet programit të financuar nga BE-ja dhe Suedia për Mbështetjen e OSHC-ve Mjedisore në Shqipëri (SENIOR-II), Qendra Rajonale e Mjedisit (REC-Shqipëri) akordoi 28 grante për OSHC-të për projektet e zbatuara nga marsi deri në tetor 2018. Më në fund, Terre des Hommes në Shqipëri shpalli shtatë nën-grante me madhësi të mesme, që variojnë nga 10,000 deri në 14,000 EUR për OSHC-të në fushën e mbrojtjes së fëmijëve nëpërmjet një projekti të financuar nga BE. Për të forcuar rolin dhe ndikimin e nismave lokale të udhëhequra nga OSHC-të dhe aktorët qytetarë, shumica e këtyre projekteve u japin përfituesve të tyre një kombinim të trajnimeve online dhe atyre në terren, trajnime individuale, rrjetëzim si dhe shkëmbim të përvojave me organizata të tjera në vend dhe rajon.





Trajnimet zakonisht ofrohen falas dhe kryesisht zhvillohen në Tiranë. Sidoqoftë, jo të gjitha OSHC-të lokale kanë mundësinë për të përfituar këtë mbështetje. Organizatat më të mëdha investojnë në trajnime më të specializuara, veçanërisht në fushat e menaxhimit strategjik, kontabilitetit dhe menaxhimit financiar, mbledhjen e fondeve, advokacinë, marrëdhëniet me publikun dhe TIK.

OSHC-të vazhdojnë të bashkëpunojnë përmes koalicioneve të bazuara në fusha specifike. Në vitin 2018, koalicionet punuan me sukses në fushat e të drejtave të njeriut dhe të drejtat e grave (Koalicioni i Strehëzave për Viktimat e Trafikimit, Rrjeti i Fuqizimit të Grave Shqiptare), zhvillimi rural (Rrjeti Rural Shqiptar - ANRD), të rinjtë (Rrjeti Kombëtar i Rinisë Shqiptare), dhe arsimit (Koalicioni Shqiptar për Arsimin). Koalicione të reja, siç është Rrjeti Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, u krijuan gjithashtu gjatë vitit 2018. Qendrat studimore në kryeqytet vazhduan të bashkëpunojnë me organizatat e bazuara në komunitet gjatë vitit 2018. Sidoqoftë, koalicionet vazhdojnë të jenë të varura nga donatorët dhe e kanë të vështirë të mbijetojnë pa donacione.

Partneritetet ndërsektoriale vijuan të jenë të dobët gjatë vitit 2018. OSHC-të kanë pak parteritete me median dhe bashkëpunimi me sektorin privat është pothuajse inekzistent.

## IMAZHI PUBLIK: 3.7

Imazhi i përgjithshëm i sektorit nuk ka ndryshuar gjatë vitit 2018. Zgjerimi i vazhdueshëm i sektorit e ka bërë të vështirë për publikun dhe donatorët të bëjnë dallimin midis "OSHC-ve cilësore" dhe "OJQ-ve fantazmë", të cilat ose janë të regjistruara por janë joaktive ose janë krijuar vetëm për të aplikuar në burime të caktuara të financimit.



Gjatë vitit 2018, media shqiptare, e cila përbëhet nga rreth 20 gazeta ditore, 71 stacione radiotelevizive, 70 stacione televizive, 109 televizione dhe qindra portale lajmesh, vazhdoi t'i japë përparësi mbulimit të zhvillimeve politike, duke treguar pak interes për shoqërinë civile. Sipas raportit të vitit 2018 të Freedom House Nations in Transit, sektori shqiptar i medias karakterizohet nga autocensura dhe lidhjet e ngushta midis politikës, biznesit dhe medias. Edhe pse për OSHC-të nuk është e lehtë të kenë akses në media, disa OSHC kanë arritur të ndërtojnë marrëdhënie produktive me median ose të punojnë me politikanë, për shembull duke ftuar figura politike të marrin pjesë në ngjarjet e tyre në mënyrë që të tërheqin mbulimin mediatic. Vazhdon të ketë një ndryshim domethënës midis shkallës së qasjes së OSHC-

ve në median kombëtare dhe vendore, ku media vendore është dukshëm më e aksesueshme. OSHC-të raportojnë se shumë media - vendore dhe kombëtare – kërkojnë pagesa nga OSHC-të që të mbulojnë aktivitetet e tyre, gjë që dekurajon ose parandalon OSHC-të (veçanërisht ato më të vogla) që të kërkojnë mbulimin mediatic.

Mediat shpesh shprehin ose transmetojnë mendime kritike ndaj OSHC-ve dhe i fajësojnë OSHC-të për rezultate që janë pjesërisht ose edhe plotësisht jashtë kontrollit të tyre. Për shembull, OSHC-të që mbrojnë barazinë gjinore dhe luftojnë kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës familjare shpesh fajësohen si joefikase dhe abuzuese të fondeve sa herë që një incident i lidhur tërheq vëmendjen e mediave.

Në këtë kontekst, OSHC-të gjithnjë e më shumë mbështeten në median sociale dhe mjete jo-tradicionale të medias për të publikuar punën e tyre gjatë vitit 2018. Sidoqoftë, përdorimi i medias social si vegël për të rritur ndërgjegjësimin ka kostot e saja, përfshirë pagesat për të reklamuar postimet në Facebook ose për të rritur numrin e ndjekësve, të cilën jo të gjitha OSHC-të mund ta përballojnë. Në përgjithësi, OSHC-të pohojnë se kanë mungesë të kapaciteteve dhe ekspertizës për sa i përket marrëdhënieve me publikun. Vetëm një numër i vogël i OSHC-ve kanë staf të përkushtuar për komunikimin dhe marrëdhëniet me publikun.

Sipas një sondazhi kombëtar të realizuar nga IDM në vitin 2018, raportohet se 57 përqind e të anketuarve raportuan se kanë besim tek shoqëria civile, e njëjta përqindje si në vitin 2017. Ky rezultat i rendit OSHC-të si institucionet e pesta më të besueshme në vend, pas institucioneve fetare (73 përqind), sistemit arsimor (64 përqind), forcave të armatosura (63 përqind) dhe policisë së shtetit (58 përqind). Në vitin 2018, pati një aktivizëm

më të madh nga OSHC-të formale, si dhe disa lëvizje informale si Lëvizja për Universitetin dhe Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar. Në përgjithësi publiku reagoi pozitivisht ndaj këtyre nismave, megjithëse është shumë herët për të përcaktuar nëse ky entuziazëm do të vazhdojë. Nuk ka studime apo të dhëna të disponueshme rreth perceptimit të qeverisë ose biznesit për shoqërinë civile.

Një numër në rritje i OSHC-ve advokojnë për transparencë dhe mirë-qeverisje, aktivizëm por tregojnë pak progres në ndërmarrjen e hapave për ta bërë vetëveten më transparent. Një mënyrë e qartë për ta vlerësuar këtë është numri tepër i ulët i OSHC-ve që publikojnë raportet e tyre vjetore online.

*Opinionet e shprehura këtu janë të panelistëve dhe hulumtuesëve të projektit, dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose FHI 360.*